



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.10.2025
Numër Protokolli: 6582/2025

A.nr.1387/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1387/2025, të datës 16.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimit: Inspektorati Qendror i Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Adminisitrativ i nisuar sipas ankesës me numër A.nr.1387/2025, të datës 16.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil A.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 16.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, i shpallur nga Inspektorat Qendror i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati Qendror i Punës, ndërsa, ky i fundit, më datë 01.09.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1387/2025, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, numri i kërkuar nëntë (9), klasa profesional 1, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs dhe sipas njoftimit 28.05.2025 për fazën e verifikimit paraprak rezulton se i njëjti ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 10.07.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me 18 kandidatë të suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër faktit që ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, nuk është ftuar në testin me shkrim edhe përkundër faktit që ka kërkuar informata lidhur me mos ftesën për test me shkrim.

Duke qenë se kandidati N.G, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A numër A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit më Nr. Ref: RN00017340.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1387/2025, të datës 16.07.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këtë procedurë, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1387/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1387/2025, të datës 16.07.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1387/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoriatin Qendror;
- Arkivit të KPMSHCK-së.